

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i përgjithshëm Divizioni Penal, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të pandehurit G.S. nga ..., rruga “ ... ” nr. ..., dhe mbrojtësin e tij M.M. avokat nga ..., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.nr.220/18 të datës 23.02.2018, që e përfaqëson Prokurorja e shtetit Sllavica Popoviq, pas mbajtjes së shqyrtimit të parë publik gojarisht, në lidhje me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe dënimit të arritur në prokurori me datën 23.02.2018, me datë 25.07.2018 në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I akuzuari G.S. nga babai F. dhe nëna K., e lindur M., i lindur më data e lindjes..., në fshatin ..., ku edhe jeton në rrugën “ ... ” nr. ..., student, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani i gjykuar për të njëjtën vepër penale, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 01.02.2018, rreth orës 12:15 minuta, në ... në rrugën “ ... ”, tek ish-kafiteria “ ... ” i pandehuri me dashje dhe me qëllim të dëmtimit të integritetit trupor të dëmtuarit E.B. e ka goditur të njëjtin pas një mosmarrëveshje paraprake lehtë rreth investimeve në lokalin e të dëmtuarit nga prindi i të pandehurit, ashtu që me të arritur te ky lokal, i pandehuri dëshiron të hyj në këtë lokal me ç’rast i dëmtuari i drejtohet me fjalët”hej ku je tu shku” duke i ngritur dorën, ndërsa i pandehuri e shtyn me forcë me të dy duartë e rrëzon për tokë dhe më pas me grusht e godet në pjesë të ndyshme të trupi kryesisht në regjionin e kokës me ç’rast i dëmtuari si pasojë e goditjeve të pësuar detyrohet të kërkojë ndihmë mjekësore, në spitalin e përgjithshëm në Gjilan-Emërgjencë sipas raportit mjekësor me nr. ... të datës 01.02.2018, të cilat sipas ekspertizës mjeko-ligjore nr.31/02-18 të datës 07.02.2018, konstatohen si dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

-Me çka ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 17, 40,41,42,46, 73 dhe 74, KPRK si dhe nenit 365, 451 dhe 463,KPP të pandehurit e gjykon me

DËNIM ME GJOBË

I. Në shumë prej 500 (pesëqind) euro të cilën i pandehuri është i obliguar ta paguaj menjëherë me plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, në rast që i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë, dënimi do të zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që çdo ditë burg do të llogaritet nga 20 euro.

II. I dëmtuari E.B. nga ..., për realizimin e kërkesës pronësore – juridike është udhëzuar në kontestin civil.

III. Në përputhje me nenin 39 paragrafin 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, i pandehuri obligohet që në emër të taksave për kompensimin e viktimave të paguaj taksën prej 30 Euro.

IV. I pandehuri obligohet që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 25 euro dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate në afat prej 15 ditëve.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.nr.220/2018 të datës 23.02.2018, kundër të pandehurit G.S. nga ..., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, dhe i ka propozuar gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të ndëshkohet sipas ligjit.

Prokurorja e Prokurorisë Themelore në Gjilan Leonora Shemsiu-Kadriu në seancën e mbajtur në lidhje me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal të mbajtur me datë 23.02.2018, ka mbetur pranë marrëveshjes së arritur mbi pranimin e fajësisë lidhur konform ligjit dhe dispozitës së nenit 233 KPPRK, me ç rast i akuzuari është njoftuar me pasojat dhe natyrën e nënshkrimit të pranimit të fajësisë, andaj mbeti pranë qëndrimit se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që gjykata në tërësi të aprovoj marrëveshjen e cekur.

Mbrojtësi i të akuzuarit G.S. avokati M.M. në tërësi është pajtuar me propozimin e prokurorit të shtetit që marrëveshja të aprovohet nga ana e gjykatës dhe se gjatë arritjes së marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë i akuzuari me vetëdije ka pranuar fajësinë dhe është pajtuar me këtë, ka garantuar se në të ardhmen nuk do të ndeshet me ligjin, pasi që në mënyrë të sinqertë ka pranuar fajësinë. I akuzuari është penduar, deri sot nuk është gjykuar, andaj lutë gjykatën që të ketë parasysh këtë fakt dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë përmban të gjitha faktet, propozimin për arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, njoftimin e të akuzuarit me të drejtat e tij si dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhënia e deklaratës me shkrim, se i

njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se të gjitha këto i ka pranuar vullnetarisht.

Gjykata konstaton se i akuzuari ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë konform nenit 233 KPPRK dhe e njëjta marrëveshje është në harmoni me kushtet e parapara me pikën 12 të këtij neni.

Gjykata vërtetoi se i akuzuari ka kryer veprën penale dhe konstatoi se nuk ka përjashtime të parapara me nenin 248 KPPRK.

Gjykata aprovoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë të lidhur në mes të PTH-Departamenti i përgjithshëm nga njëra anë, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij nga ana tjetër për kryerjen e veprës penale të cekur në aktakuzën PP.nr.220/18 të datës 23.02.2018, pasi që për këtë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore.

Gjykatësja individuale vlerëson se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e të pandehurit, e pas konsultimeve me mbrojtësin e tij, se i pandehuri nuk ka qenë i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë. Pranimi i fajësisë është i mbështetur në faktet e cekura në aktakuzë, andaj nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 253 paragrafi 1 KPPRK.

Gjykata është e bindur se dënimi me kusht është në harmoni me peshën e veprës penale dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është bazuar në nenin 451 KPRK, kurse vendimi për kërkesën pronësore-juridike në bazë të nenit 463 të KPRK-së.

Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

**Departamenti i përgjithshëm
P.nr.215/2018 të datës 25.07.2018**

**Sekretarja juridike,
Suzana Kovaçeviq**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Snezhana Mihajloviq**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.

**Përktheu:
Ardijana Aliu**